



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644 – 19 – 7152 – 1-2-1/C223  
14 Nr. 1160/19  
Dt. 05.11.2019

## KONTRATË FURNIZIMI

### Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Agrium** “sh.p.k. me seli në **Leshkobare / K. Ferizaj** , me NRB: 70992671 e NRF: 601018593, si Operator Ekonomik, të cilën e përfaqëson : **Leutrim Isufi** , në tekstin e mëtejme : **FURNITORI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për furnizim dhe / ose shërbime, si vijon: **Ngritja e pemishteve ( arrë lajthi )** me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	71	5	2	1	2	1
Prokurimi Nr.	644	1	9	1	1	1	1	2	1

### Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe / ose shërbimeve nga ana e Kontraktuesit - Furnizuesit, si vijon : **Ngritja e pemishteve ( arrë lajthi )** sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : 644-19-111-121.

### Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: **15 ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.**
- 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë si vijon : Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së fidanëve do të bëhet nga Komisionit të Pranimit të Mallit, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues, në momentin e dorëzimit të fidanëve, që janë lëndë e kësaj kontrate. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës dhe Komisionit të Pranimit të Mallit të Autoritetit Kontraktues.
- 2.3 Furnizuesi merr për obligim dhe pajtohet që materiali fidanor të jetë në pajtueshmëri të plotë me Specifikat Teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit. Po ashtu Kontraktuesi pajtohet që materialin fidanor dhe pajisjet tjera përcjellëse të saktësuara në Përshkrim të Çmimeve dhe Specifikat Teknike të Dosjes së Tenderit ta dërgoi – transportoi, me shpenzime dhe mjet transporti të tija, deri te vendbanimi i përfituesit, sipas regjistrit

të përfituesve të aprovuar nga Njësia Kërkuese – Shpenzuese. Një herit Furnizuesi merr për obligim që secilit fermer përfitues të materialit fidanor ti ofroi shërbime të aftësisimit dhe informimit të mjaftueshme në bashkëpunim me personat kompetent të Autoritetit Kontraktues, lidhur me mënyrën e kultivimit të materialit fidanor.

- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.4 Garancioni për cilësinë dhe përshtatshmërinë e materialit fidanor do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit.
- 2.5 Nëse Kontraktuesi me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda afatit kohorë të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
- 2.3 Vendi i dorëzimit të furnizimeve dhe / ose shërbimeve do të jetë vendi i saktësuar nga Njësia e Kërkesës së Autoritetit Kontraktues, që në këtë rast do të jenë përfituesit e materilit fidanorë ( arrë dhe / ose lajthi ) sipas Rexhistrit të aprovuar nga Njësia Kërkuese.

### **Neni 3 Çmimi**

- 3.1 Çmimi total i furnizimeve të materialit fidanor është në shumë prej : 18.854,60€( tetëmbëdhjetmijtetqindpesdhjetekatër /60€ ).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do ti nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.
- 3.3 PAGESAT DO TË BËHEN NË PAJTIM ME KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE/OSE TË VEÇANTA TË KONTRATËS, RESPEKTIVISHT PAS PRANIMIT TË PAISJEVE nga ana e Komisionit për Pranim të Mallit të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

<sup>17</sup> DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe<sup>2</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

### Për Autoritetin Kontraktues:

<b>Emri:</b>	Saranda Cakaj
<b>Pozita:</b>	Drejtoreshë për Prokurim Publik
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	05.11.2019
<b>Vula:</b>	



### Për Kontraktuesin - Furnizuesin:

<b>Emri:</b>	Leutrim Isufi
<b>Pozita:</b>	Përfaqësues i : " Agrium "sh.p.k. - Ferizaj
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	05.11.2019
<b>Vula:</b>	



<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

## Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

### Specifikimi teknik per fidane te arres

Nr	Përshkrimi	Njësia / ha	Nr. i përfituesve
1	Ngritja e pemishtës në sip. prej 0.50 ha <b>arrë</b>	<b>0.50 ha</b>	<b>14</b>

- ❖ Fidanët duhet të jenë të certifikuara dhe të posedojnë gjithë dokumentacionin përcjellës nga vendi i origjinës dhe prodhuesi duhet të sjell licencën e prodhuesit të materialit fidanor
- ❖ Furnizuesi duhet të sjell certifikatën e gjendjes shëndetësore të materialit fidanor
- ❖ Sistemi i ujitjes(pik pik) të ketë fletëgarancinë se paku 3 vite (36 muaj).

### Sistemi i ujitjes

Gypi shpërndarës Ø20mm , me pikatore në distancë çdo 50cm,me kapacitet 4 l/h për piaktore

### Specifikimi teknik per fidane te lajthisë

Nr	Përshkrimi	Njësia / ha	Nr. I përfituesve
1	Ngritja e pemishtes në sip. prej 0.50 ha Lajthi	<b>0.50 ha</b>	<b>10</b>

Numri i Prokurimit: VU644-19-7152-1-2-1– Titulli **Ngritja e pemishteve (Arra, Lajthi)**

- ❖ Fidanët duhet të janë të certifikuara dhe te posedojnë gjithë dokumentacionin përcjellës nga vendi i origjinës dhe prodhuesi duhet të sjell licencën e prodhuesit të materialit fidanor
- ❖ Furnizuesi duhet te sjell certifikatën e gjendjes shëndetësore te materialit fidanor
- ❖ Sistemi i ujitjes(pikë pikë) të ketë fletëgarancinë se paku 3 vite (36 muaj)

Ngritja e pemishteve të reja me kulturën e lajthis të bëhet me material i cili i plotëson të gjitha standardet e parapara sipas Ligjit për materialin fidanor Nr.2004/13 të datës 28.05.2004.

**Fidanët e Lajthisë** Fidanët duhet te jene 2 vjeçare dhe te degëzuara

Kultivarët e rekomanduar të Lajthisë (Kosford, Lambert, Ludolf, Enis, Rojal, Montarela, Lamberti i kuq ), të jenë të përshtatshme për kushtet klimatike të Kosovës, të lira prej sëmundjeve dëmtuesve dhe prezencës së viruseve (dëshmi edhe fito certifikata).

Furnizuesi duhet të ketë parasysh që pas zgjedhjes Agronomët e Komunës së Vushtrisë në bashkëpunim me furnizuesin mund të adaptojnë kultivarët sipas skenave të pemishteve të përfituesve por numri i përgjithshëm i fidanëve dhe lista e kultivarëve nuk do të ndryshojë.

### **Fidanë te lajthisë**

\*Fidanë dyvjeçare (pjesa e poshtme e padegëzuar ) me degëza veshës të parakohshme njëvjeçare;

\*Të posedojnë të paktën 5-7 degëza veshëse ;

\*Të gjitha degëzat veshëse përafërsisht duhet ta kenë të njëjtën trashësi ;

\*Gjatësia e tërësishme e fidanit duhet me qenë 1,5m,përfshirë këtu edhe sistemin rrënjor ;

\*Të kenë sistem rrënjor të zhvilluar mirë ;

### **Sistemi i ujitjes**

Gypi shpërndarës Ø20mm , me pikatore (1320 pikatore për fermer)me kapacitet 4 l/h për pikatore

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuhët në përdorim zyrtarë.
Siguria e ekzekutimit	9.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, me afat prej 50 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës.
Sigurimi	10.1	Sigurimi i ofertës N/A
Programi i ekzekutimit	11	Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, furnizimet duhen përfunduar në një afat jo më gjatë se 15 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Gjitha detyrimet doganore dhe tatimore sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, bien në barrë të Op.Ek. - Kontraktuesit
Patentat dhe licencat	13.1	
Cilësia e furnizimeve	18.2	Pranimi paraprak është i nevojshëm dhe do të kryhet nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallit – fidaneve arre dhe lajthi.
Inspektimi dhe testimi	19.2	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së mallit do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të Mallrave- fidaneve arre dhe lajthi. – të Autoritetit Kontraktues.  Asnjë furnizim i mallit nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të Mallrave – makinave/Pajisjeve të Autoritetit Kontraktues.
Pagesa	20.1	Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit dhe Komisioni i Pranimit të mallit, pagesa do të


Numri i Prokurimit: VU644-19-7152-1-2-1– Titulli Ngritja e pemishteve (Arra, Lajthi)

		kryhet në afat sa më të shurtër kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit të faturës.
Dorëzimi	21.3	Dorëzimi konsiderohet i përfunduar pas pranimit dhe konfirmimit të cilësisë së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pranuar Komisioni për pranimit të mallrave dhe shërbimeve.  Furnizuesi – Kontraktuesi merr për obligim që pas pranimit të pajisjeve të bëjë trajnimin dhe aftësimin e fermerëve (përfituesve) për mënyrën e përdorimit dhe funksionimin e pajisjes, nga stafi i tij profesional dhe i certifikuar.
Obligimet e garancionit	24.1	Deklaratë garantuese për sistemin e ujitjes pike-pike 3 vite (36 muaj) nga data e pranimit të mallit.
	24.5	
Shërbimet pas shitjes	25.1	Furnizuesi duhet të siguroj Kontraktuesin se malli i dorëzuar – pranuar si dhe ekzekutimi i shërbimeve të porositura, nën konditat e ruajtjes dhe përdorimit në kushte dhe kondita të pranuar, do të ketë cilësi të pranueshme për një periudhë kohore prej së paku 36 muaj për sistemin e ujitjes pike-pike.  Në rast dështimi të mallit të pranuar Kontraktuesi merr për obligim që, me shpenzime të tija dhe pa asnjë kompesim nga Autoriteti Kontraktues, të bëjë ndrrimin mallit – pajisjes së pranuar.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.


Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G  
 Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8%-apo-18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, çmimi duhet shkruhet në 2 (dy) decimale pasë presjes dhjetore

## A: Fidane arrë

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia për 14 përfitues	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Vlera (Pa TVSH)	TVSH	Vlera (me TVSH)-€
1	Fidanët (Chandler, Rasna, Franquete, Shampon)	copë	1512	2.90		2.90	4,384.80	0.00	4,384.80
2	Sistemi i ujitjes pik pik	m	10360	0.08		0.08	828.80	0.00	828.80
3	Gypi kryesor I ujit (Ø 5/4) +mbyllësi (Ø5/4)	m	700	0.59	18.00	0.70	415.25	74.75	490.00




4	Ventili (6 x 20) me mbyllës	copë	84	6.78	18.00	8.00	569.49	102.51	672.00
5	Rezervar për ujë 1000 litra	copë	14	38.14	18.00	45.00	533.90	96.10	630.00
6	Pleh mineral NPK 15:15:15 ose 10:20:30(kg)	kg	3850	0.34		0.34	1,309.00	0.00	1,309.00
7	Gërshërë për krasitje për pemë tip kuker ose falcet	copë	14	16.95	18.00	20.00	237.29	42.71	280.00
8	Pompë spërkatëse 20 l me bateri	copë	14	21.19	18.00	25.00	296.61	53.39	350.00
<b>TOTALI PËRGJITSHËM ME TVSH:</b>									
				8,575.14			369.46		8,944.60
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia për 10 përfitues	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)-€	Vlera (Pa TVSH)	TVSH	Vlera (me TVSH)-€



## B: Fidane lajthi


1	Fidane te lajthise	copë	3400	1.50		1.60	5,100.00	340.00	5,440.00
2	Sistemi ujitës (gypi kryesor 6/4)	M	550	1.36	18.00	1.60	745.76	134.24	880.00
3	Gyp sekondar pik pik 20mm me pikatore (680 pikatore për fermer)	m	10000	0.12		0.12	1,200.00	0.00	1,200.00
4	Ventil mbyllës 20 mm	copë	220	0.40		0.40	88.00	0.00	88.00
5	Mbyllës i gypit 20 mm	copë	220	0.10		0.10	22.00	0.00	22.00
6	Filter 6/4	copë	10	14.00		14.00	140.00	0.00	140.00



7	Mbyllës i gypit 6/4	copë	10	4.24	18.00	5.00	42.37	7.63	50.00	
8	Rezervuar i uji 1000 l	copë	10	38.14	18.00	45.00	381.36	68.64	450.00	
9	Gërshtëre për krasitje për pemë tip kuker ose falcet	copë	20	16.95	18.00	20.00	338.98	61.02	400.00	
10	Pompë spërkatëse 20 l me bateri	1	10	18.64	18.00	22.00	186.44	33.56	220.00	
11	Pleh mineral NPK 15:15:15 ose 10:20:30(kg)	kg	3000	0.34		0.34	1,020.00	0.00	1,020.00	
<b>TOTALI PËRGJITHSHËM ME TVSH:</b>							<b>9,264.92</b>		<b>645.08</b>	<b>9,910.00</b>

## R E K A P I T U L I M I

<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera me TVSH</b>	<b>në</b>
		€	



Numri i prokurimit:644-19-111-121 Titulli: Ngritja e pemishteve (arra, lajthi)

A	A: Fidane arrë	8,944.60
B	B: Fidane lajthi	9,910.00
TOTALI PËRGJITHSHËM pa TVSH=		17,840.06
TVSH=		1,014.54
TOTALI PËRGJITHSHËM ME TVSH = A+B		18,854.60

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	AGRIUM SH.P.K.
EMRIT DHE MBEMERIT I PËRFAQËSUESIT TË OE:	LEUTRIM ISUFI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	11.10.2019
VULA:	